



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 shkronja h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, parashtron këtë:

PROPOZIM

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, si dhe nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____, të miratojë këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 14,690.00 € (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), për kryerjen e obligimeve që rrjedhin konform dispozitave të Marrëveshjes trevjëqare për Bashkëpunim që përfshin periodën kohore 2020-2022 të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit "Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës 18.03.2020 në të cilën përcaktohet që Komuna e Lipjanit do të participojë me 20% të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur duke u bazuar në Kërkesën e IADK-së me numër 12-320-55638 për bashkëfinancim të projektit të parashtruar me datë 15.09.2021 lidhur me aktivitetet e realizuara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer në Komunën e Lipjanit ku Komuna e Lipjanit obligohet të bashkëfinancoj me mjete financiare në vlerë prej 7,020.00 € dhe Kërkesën e parashtruar poashtu

nga IADK me numër 12-320-60319 e datës 30.09.2021 lidhur me aktivitetet e zhvilluara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë dhe menaxhimit të biznesit si dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer të rinjë dhe poashtu përkrahja e grave me trajnime profesionale për përpunim të qumështit dhe përpunim të pemëve dhe perimeve në vlerë prej 7,670.00 ku vlera e përbashkët për këto projekte përfshin shumën prej 14,690.00 € (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës-kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozimin- Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, si dhe neni 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës 18.03.2020.


Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës 18.03.2020 në të cilën përcaktohet që Komuna e Lipjanit do të participojë me 20% të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur duke u bazuar në Kërkesën e IADK-së me numër 12-320-55638 për bashkëfinancim të projektit të parashtruar me datë 15.09.2021 lidhur me aktivitetet e realizuara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer në Komunën e Lipjanit ku Komuna e Lipjanit obligohet të bashkëfinancoj me mjete financiare në vlerë prej 7,020.00 € dhe Kërkesën e parashtruar poashtu nga IADK me numër 12-320-60319 e datës 30.09.2021 lidhur me aktivitetet e zhvilluara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë dhe menaxhimit të biznesit si dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer të rinjë dhe poashtu përkrahja e grave me trajnime profesionale për përpunim të qumështit dhe përpunim të pemëve dhe perimeve në vlerë prej 7,670.00 ku vlera e përbashkët për këto projekte përfshin shumën prej 14,690.00 € (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura ligjore dhe me qëllim të kryerjes së obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e cekur për zbatimin e Projektit "Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 016-74546
Lipjan, më 06.12.2021

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti





INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM – (MpB)

Nr. Br. 320-16457

në mes të

Data/Datum 18.03.2020

- Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, me regjistrim Nr: 5200122-6 – përfaqësuar nga z. Zenel Bunjaku, Drejtor, në tekstin e mëtejshëm i referuar si "IADK"

dhe

- Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i komunës, në tekstin e mëtejshëm i referuar si "Komuna e Lipjanit"

**Neni 1
Lënda e MpB**

IADK-ja dhe Komuna e Lipjanit (tani e tutje referuar si Palët) pajtohen të rregullojnë një bashkëpunim të afërt me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe përkrahjes me grante për fermerët, gratë, të rinjtë dhe studentët në Komunën e Lipjanit.

**Neni 2
Qëllimi**

2.1 Kjo MpB ka qëllimin të përshkruajë bashkëpunimin në mes të Palëve gjatë periudhës 2020-2022, bazuar në zbatimin e projektit "Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës" i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK, që do të shtrihet në komunat: Vushtrri, Skenderaj, Lipjan, Shtime, Viti dhe Kamenicë. Përmes këtij projekti synohet ngritja e kapaciteteve profesionale dhe përkrahja direkte me grante në sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore, si dhe investimi në ndërtimin e një objekti shtesë-njësisë përpunuese për demonstrimin e praktikave gjatë trajnimeve në sektorin e përpunimit të prodhimeve bujqësore.

2.2 Projekti do të arrijë rezultate të prekshme, nga ku do të mbështeten:

2.1.1 do të përkrahen 105 të rinj me këshilla praktike dhe teorike me qëllim punësimi dhe gjenerimi të të ardhurave, nga të cilët 15 do të kenë mundësi punësimi pas punës praktike dhe 50 të tjerë do të përkrahen me grante për vetë punësim,

2.1.2 do të trajnohen dhe aftësohen 240 gra në fushën e përpunimit dhe do të certifikohen

2.1.3 do të ngriten pesë (5) pika përpunuese (fruta, perime, ëmbëlsira) dhe do të punësohen 15 gra të tjera,

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11

42000 Vushtrri

*Të jetojnë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org

- 2.1.4 do të afësohen 90 fermerë të sektorëve potencial me këshilla praktike dhe teorike, nga ku do të mbështeten me grante 74 fermer me qëllim të vetë punësimit,
 2.1.5 do të mbështeten 130 nga total përfituesit me trajnime në përmirësim të marketingut,
 2.1.6 do të marrin pjesë 190 përfitues në vizita për shkëmbim të eksperiencave brenda Kosovës,

Neni 3

OBLIGIMET E KOMUNËS SË LIPJANIT

Bashkëfinancimi në grantet përkrahëse për përfituesit dhe aftësimin profesional të tyre

Komuna e Lipjanit gjatë viteve 2020-2022 në varësi të mundësive buxhetore do të bashkëfinancoj në projektet përkrahëse të IADK-së, të cilat do të shpërndahen për përfituesit e Komunës së Lipjanit, me vlerë prej 20 % të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur. Në bazë të nevojave të fermerëve, dakordimit mes IADK-së dhe drejtoratit të bujqësisë, mënyra e përkrahjes me grante mund të jetë si vijon:

- 3.1 Për përkrahje me grante direkte për një fermer përfitues, vlera mesatare e përkrahjes do të jetë 3,000.00 € (IADK 2,100.00 €, Komuna e Lipjanit 600.00 € dhe Përfituesi 300.00 €);
- 3.2 Për përkrahje me grante direkte për një përfitues të njësisë përpunuese (peme, perime, qumësht, ëmbërsiara etj), vlera mesatare e një granti për femra do të jetë 12,000.00 € (IADK 8,400.00 €, Komuna e Lipjanit 2,400.00 € dhe Përfituesja 1,200.00 €);
- 3.3 Për përkrahje në shpenzimet operacionale (përzgjedhja e përfituesve, këshilla direkte, trajnime, vizita, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontrates me përfitues), të cilat do të llogariten sipas numrit të përfituesve dhe vlerës së grantit për përfituesin;
- 3.4 Në rastin e grantit në vlerë prej 3,000.00 € - shpenzimet operacionale do të jenë 900.00 €, (720.00 € IADK dhe 180.00 € Komuna e Lipjanit);
- 3.5 Në rastin e grantit për njësi përpunuese në vlerë prej 12,000.00 € - shpenzimet operacionale përfshir këtu edhe trajnimin grupor prej 10-15 gra do të jenë 3,600.00 €. (2,880.00 € IADK dhe 720.00 € Komuna e Lipjanit);
- 3.6 Numri i përfituesve (fermerëve, studentëve, grave, të rinjëve) do të varet nga buxheti në dispozicion të cilin IADK do ta siguroj nga donatorët (në këtë rast nga Donatori BfdW nga Gjermania), numrit të aplikacioneve, numrit të përfituesve që plotësojnë kriteret;
- 3.7 Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet nga komisioni i përbashkët me ekspert të IADK-së dhe Komunës së Lipjanit;
- 3.8 Komuna e Lipjanit do të kryejë pagesat sipas obligimeve të cekura në nenin 3, pasi IADK të dorëzoj raportin dhe kërkesën për pagesë për projektet e realizuara me numrin e përfituesve;
- 3.9 Pagesa do të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr.xhir:2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së, dhe jo më vonë se fundi i muajit nëntor të vitit përkatës, kur realizohen projektet.

Neni 4

OBLIGIMET E IADK-së

- 4.1 IADK do të organizojë një sesion informues përmes të cilit pjesëmarrësit do të njohohen lidhur me qëllimin e projektit, aktivitetet e projektit, si dhe mënyrën se si mund të përfshihen në projekt;
- 4.2 IADK do të punojë ngushtë me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Lipjanit në përzgjedhjen, monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteve të përfituesve;
- 4.3 IADK është përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e tërë procesit të furnizimit dhe shpërndarjes së artikujve, pajisjeve dhe materialeve që e përbëjnë paketat specifike për përfituesit e granteve;
- 4.4 IADK do të organizojë trajnime, këshilla direkte, vizita, monitorime të rregullta për përfituesit, si dhe ofron materiale të nevojshme trajnuese;

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
 42000 Vushtri

Të jetojnë nga toka dhe puna jonë!
 Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



- 4.5 IADK do të angazhojë studentë për përkrahje me punë praktike me pagesë. Numri i tyre varet nga interesimi dhe plotësimi i kriterëve. Puna praktike për student mund të kryhet edhe në Komunën e Lipjanit, brenda departamenteve përkatëse;
- 4.6 Për punën praktike tremujore për çdo student të Komunës së Lipjanit, të përzgjedhur për përkrahje me punë praktike mbështetja financiare për shpenzime të transportit, ushqimit dhe komunikimit do të jetë 600.00 € nga IADK (200 € / 1 muaj);
- 4.7 IADK pas realizimit të projekteve do të raportojë tek Komuna e Lipjanit për rezultatet e arritura nga aktivitetet e realizuara në kudër të kësaj MpB.

Neni 5

Personat Kontaktues

- 5.1 Palët do të emërojnë nga një përfaqësues që të rregullojnë kontaktet me të lehta dhe të drejtpërdrejta në mes dy partnereve. Këta persona do të përfshihen drejt për së drejti në implementimin e qetë dhe kohor të kësaj MpB.
- 5.2 IADK do të përfaqësohet nga z. Sylejman Bunjaku, ndërsa Komuna e Lipjanit nga z. Afrim Sadiku.

Neni 6

Pajtueshmëria me ligjin

- 6.1 Kjo marrëveshje do të zbatohet në pajtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.
- 6.2 Kjo marrëveshje nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë marrëveshje bashkëpunimi që palët e kanë me palë të treta.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Palët do të zgjidhin në mënyrë miqësore, me bisedime, të gjitha mosmarrëveshjet, kundërtënie apo ankesat që dalin, apo janë të lidhura me këtë Marrëveshje.
- 7.2 Nëse njëra nga palët argumenton mos zbatimin e kësaj marrëveshjeje, dhe atë vetëm pas konsultimeve paraprake me palën tjetër, atëherë ajo palë mund të tërhiqet nga marrëveshja.

Neni 8

Zgjatja amendamentimi dhe përfundimi i marrëveshjes

- 8.1 Palët mundën, me marrëveshje të dyanshme me shkrim, të zgjasin apo ndryshojnë dhe plotësojnë këtë marrëveshje.
- 8.2 Në rast të mosmarrëveshjes/pakënaqësisë nga ndonjëra palë, MpB mund të ndërpritet para afatit të paraparë duke dhënë një njoftim me shkrim 1- muaj më parë.

Neni 9

Përpilimi

Kjo marrëveshje është e përpiluar në një ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe për çdo palë. Secila palë do ta ketë një ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe të nënshkruar dhe të vulosur.

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11

42000 Vushitri

*Te jetojnë nga loka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo MpB përfshinë periudhën nga Mars 2020 deri në Dhjetor 2022, dhe hynë në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dy palët.

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së
Kosovës (IADK)

Zenel Bunjaku, Drejtor Ekzekutiv

Vushtri 18/3/2020

Komuna e Lipjanit

Imri Ahmeti

Lipjan 18/3/2020



Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtri

Je jetojmë nga loka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 04777036

Web: www.iadc.org



Për	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari /Komuna e Lipjanit/ Shefqet Amurllahu - Drejtor
Nga	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, e përfaqësuar nga: Zenel Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv
Lënda	Kërkesë për bashkëfinancim të projektit nga Komuna e Lipjanit për vitin 2021
Datë	15.09.2021

Ju njoftojmë se IADK bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpunim (MpB) të datës 18.03.2020 në mes IADK-së dhe Komunës së Lipjanit për bashkëfinancim të projekteve të IADK-së, si dhe dakordimit me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Lipjanit gjatë vitit 2021 janë zhvilluar aktivitetet në ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer në Komunën e Lipjanit.

Në tabelën 1, janë paraqitur të dhënat e të rinjëve përfitues të granteve dhe llojet e artikujve që janë shpërndarë te përfituesit.

Tabela 1: Përfituesit e granteve në sektorin e perimeve					
Nr.	Fmeri	Komuna	Vendbanimi	Nr. i Lnjofitimit	Lloji i grantit
1	Lumbardh Qerimi	Lipjan	Gadime	1244906598	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
2	Xhevat Krasniqi	Lipjan	Aklap	1245225691	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
3	Xhafer Danushi	Lipjan	Resinoc	1013554117	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
4	Arjan Jezerci	Lipjan	Rubofc	1231753610	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
5	Sead Maholli	Lipjan	Gadime e Ulët	1234084492	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
6	Behxhet Drenica	Lipjan	Shale	1015750401	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
7	Rexhep Sllamniku	Lipjan	Topliqan	1247964084	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
8	Muhamet Kryeziu	Lipjan	Silovi	1015153137	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë
9	Nora Hajrizi	Lipjan	Gumnasellë	1234395811	Serra 176m ² , inpute, motokultivator-frezë

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primitjen:		
15.09.2021		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
12-320	55638	

Adresa:
Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org
Tel: 049777046 & 044777036
Web: www.iadc.org

Ndërsa në tabelën 2, janë paraqitur të dhënat për realizimin e granteve dhe forma e bashkëfinancimit.

Tabela 2: Kostoja e bashkëfinancimit për grantet përkrahëse për përfituesit në sektorin e perimeve - kontributi i palëve

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna e Lipjanit	Përfituesit
1	Grante për fermer në sektorin e perimeve (serra me sipërfaqe prej 176 m ² , motokultivator frezë, sistem të ujitjes, fara/fidane dhe inpute përcjellëse)	Fermer	9	3,000.00	27,000.00	18,900.00	5,400.00	2,700.00
	Total Direkte		9		27,000.00	18,900.00	5,400.00	2,700.00
2	Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte, trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontrates me përfitues				8,100.00	6,480.00	1,620.00	-
	Buxheti total				35,100.00	25,380.00	7,020.00	2,700.00
						IADK	Komuna	Fermeri
						72%	20%	8%

Investimi total në Komunë 35,100.00

Prandaj kërkojmë që të bëhet pagesa për bashkëfinancim të projekteve të realizuara për vitin 2021, ku Komuna e Lipjanit duhet të paguaj mjetet financiare në vlerë prej 7,020.00 €, në xhirollogari të IADK-së.

Pagesa të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr. Xhirollogarisë 2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së.

Bashkangjitur: Raporti final i realizimit të projekteve
Marrëveshja për Bashkëpunim (MpB)
Kopjet e kontratave të nënshkruara nga tri palët

Kërkesë nga:

Zoneli Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv



Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtri

*Që jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*


E-mail: info@iadc.org

Tel: 049777046 & 044777036

Web: www.iadc.org



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSO
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Për	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari /Komuna e Lipjanit/ Shefqet Amurllahu - Drejtor
Nga	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, e përfaqësuar nga: Zenel Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv
Lënda	Kërkesë për bashkëfinancim të projektit nga Komuna e Lipjanit për vitin 2021
Datë	30.09.2021

Ju njoftojmë se IADK bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpunim (MpB) të datës 01.03.2021 dhe Shtojcës Amandamentim/Korigjim i MpB të datës 30.03.2021, në mes IADK-së dhe Komunës së Lipjanit për bashkëfinancim të projekteve të IADK-së, si dhe dakordimit me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari të Komunës së Lipjanit, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar aktivitetet në ngritjen e kapaciteteve profesionale të të rinjëve në sektorin e bujqësisë dhe menagjimit të biznesit, si dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer të rinj, dhe po ashtu përkrahja e grave me trajnime profesionale për përpunim të qumështit dhe përpunim të pemëve dhe perimeve, e që do të pasohet me ngritjen e një Njësie për përpunimin e qumështit ose përpunimin e pemëve dhe perimeve në Komunën e Lipjanit.

Në tabelën 1, janë paraqitur të dhënat e të rinjëve përfitues të granteve dhe llojet e artikujve që janë shpërndarë të përfituesit.

Tabela 1: Lista e të rinjëve përfituesve të granteve përkrahëse në sektorin e bujqësisë

Nr.	Femeri	Komuna	Vendbanimi	Nr. i L.njoftimit	Loji i grantit
1	Lumturije Hyseni	Lipjan	Silovi	1235276948	Serrë 136m ² , inpute përcjellse dhe fara/ fidane
2	Adnan Shabani	Lipjan	Letiq	1172922895	Serrë 136m ² , inpute përcjellse dhe fara/ fidane
3	Natyrë Reçica	Lipjan	Llugaxhi	1247636936	Serrë 136m ² , inpute përcjellse dhe fara/ fidane
4	Alban Hajdini	Lipjan	Rufc i Vjetër	1232503242	Mekanizem/pajisje bujqësor
5	Kushtrim Sefa	Lipjan	Vrellë e Magurë	1174722346	Mekanizem/pajisje bujqësor
6	Kaltrina Zeneli	Lipjan	Mirenë	1242298647	Mekanizem/pajisje bujqësor
7	Leutrim Vishesella	Lipjan	Ribar i Vogël	1243972287	Mekanizem/pajisje bujqësor
8	Blerim Isufi	Lipjan	Gadime e Epër	1245197159	Mekanizem/pajisje bujqësor
9	Merita Kadrijaj Hot	Lipjan	Ribar i Madhë	2173368537	Pajisje për bletari

Përfituesja e pajisjeve për ngritje të Njësies Përpunuese, do të përzgjedhet dhe përkrahet me pajisje pas përfundimit të programit të trajnimeve të grave.

Adresa:

Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtri

Je se lajmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org
Tel: 049777046 & 044777036
Web: www.iadc.org



Ndërsa në tabelën 2, janë paraqitur të dhënat për realizimin e granteve dhe forma e bashkëfinancimit.

Tabela 2. Kostoja e bashkëfinancimit për grantet përkrahëse për të rinjtë përfitues - kontributi i palëve

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Njësia	Nr. i përfituesëve	Investimi €/përfitues	Totali €	Pjesëmarrja e partnerëve		
						IADK dhe Donatorët	Komuna	Përfituesit
1	Grante për të rinjtë në sektorin e perimeve (serra me sipërfaqe 136m ² , fara/fidane dhe inpute përcjellëse)	Fermer	3	2,500.00	7,500.00	5,250.00	1,500.00	750.00
2	Grante për të rinjtë në sektorin e mekanizmit bujqësor (mjete/pajisje bujqësore)	Fermer	5	2,500.00	12,500.00	8,750.00	2,500.00	1,250.00
3	Grante për të rinjtë në sektorin e bletarisë (pajisje për bletari)	Fermer	1	2,500.00	2,500.00	1,750.00	500.00	250.00
4	Ngritja e Njesisë përpunuese (pemëve, perimeve apo qumështit)	Fermer	1	7,000.00	7,000.00	4,900.00	1,400.00	700.00
Total direkte					29,500.00	20,650.00	5,900.00	2,950.00
5	Shpenzimet e ekspertëve (stafit) operacionale: këshilla direkte, trajnime, komunikime, materiale edukuese, raportimet dhe monitorimet sipas kontratës me përfitues				8,850.00	7,080.00	1,770.00	-
Buxheti total					38,350.00	27,730.00	7,670.00	2,950.00
						IADK	Komuna	Fermeri
						72%	20%	8%

Investimi total në Komunë 38,350.00

Prandaj kërkojmë që të bëhet pagesa për bashkëfinancim të projekteve të realizuara për vitin 2021, ku Komuna e Lipjanit duhet të paguaj mjetet financiare në vlerë prej 7,670.00 €, në xhirollogari të IADK-së.

Pagesa të bëhet në TEB Bankë në depozitim në Nr. Xhirollogarisë 2027-000021-7128-84, në emër të IADK-së.

Bashkangjitur: Raporti final i realizimit të projekteve
Marrëveshja për Bashkëpunim (MPB) dhe Shtojca 1, e MPB
Kopjet e kontratave të nënshkruara nga tri palët

Kërkesë nga:
Zenel Bunjaku



Adresa:
Sfaraçak i Ulët nr.11
42000 Vushtrri

Është jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!

E-mail: info@iadc.org
Tel: 049777046 & 044777036
Web: www.iadc.org